



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për**

**Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Gjydhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1232\_10\_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **27.10.2014**.

**në seancën e mbajtur më datë 11 nëntor 2014, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit E. D. me shifër DPR - 90046014 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Shfuqizohet** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1232\_10\_14 i datës 09.10.2014, dhe **mbetet në fuqi** përgjigja/vendimi i KEDS-it i datës 11.02.2014.

**Arsyetim**

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 04.12.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën nëntor 2013 me shpenzim prej 1163 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 75.18€, me datë 05.01.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2013 me shpenzim prej 3,564 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 222.80€, dhe me datë 04.02.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën janar 2014 me shpenzim prej 1,532 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 96.62€. Pas arritjes së këtyre faturave konsumatori me datë 13.01.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo korrekt, si dhe duke theksuar se të shikohen harxhimet gjatë një viti më parë pasi që gjendja ka qenë 0 gjithë vitin 2013 ndërsa tani arrijnë faturat 5 herë më të mëdha.

Me datë 03.02.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 41661162, ku gjendja në momentin e inspektimit ka qenë: TL=21202 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 44125 kWh (tarifa e ulët).

Me datë 23.01.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalin e inspektimit nr. 0914777 të datës 03.02.2014.



Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 10.30.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas kësaj ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 09.10.2014 ka nxjerrë vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i që të korrigjoj konsumatorin me shifër DPR – 90046014 në vlerë prej -20.87€, duke bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 10/2013 e deri më 01/2014.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, për shkak se konsideron se është dëmtuar më shumë se sa që DMK në ZRRE ka korrigjuar në vendimin e tyre. Konsumatori thekson se është pagues i rregullt i energjisë elektrike që nga regjistrimi i i njehsorit elektrik para shtatë viteve dhe atë gjerë në periudhën e muajit nëntor 2013, dhjetor 2013 dhe janar 2014, pasi që vlerat e këtyre faturave kanë qenë të stërfishuara. Konsumatori në ankesë ka theksuar se kërkon nga Bordi i ZRRE-së të merren për bazë harxhimet nga janari 2013 duke i përjashtuar 3 faturat kontestuese, si dhe harxhimet e janarit e 2014 gjerë në tetor 2014.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 11 nëntor 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka dëmtuar konsumatorin financiarisht gjatë vendosjes së kësaj çështje. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pas arritjes së faturave për muajin nëntor 2013, dhjetor 2013 dhe janar 2014 dhe ankesës së konsumatorit ndaj këtyre faturave, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 03.02.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë evidentuar gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrik në njehsor e cila gjendje e shpenzimit në procesverbal përputhet me shpenzimin e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së për të vërtetuar më saktë se gjendja e faturuar në periudhat kontestuese a përputhet me listat leximit, ka analizuar edhe listat e leximit të periudhave 09/2013, 11/2013, 12/2013 dhe 02/2014 dhe gjatë analizimit ka konstatuar se gjendja e evidentuar në këto lista të leximit përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike. Pra sipas këtyre listave të leximit dhe rrjedhës së energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim të saktë dhe të rregullt. Por që gjatë analizës së bërë listës së leximit të periudhës së muajit 10/2013 është vërejtur se në muajin 10/2013 kemi faturim me vlerësim/paushall nga ana e KEDS-it dhe se kjo faturë është me shpenzim të njëjtë si ajo e periudhës 09/2013.

Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se DMK në ZRRE për shkak të listës së leximit të muajit 10/2013 në të cilën konstatohet se nuk ka lexim të njehsorit elektrik nga ana e KEDS-it por ka faturim pa matje/paushall, ka bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike nga periudha 10/2013 e deri më 01/2014 dhe ka korrigjuar konsumatorin në vlerë financiare prej -20.87€. Sipas llogaritjeve të DMK-së në ZRRE është marrë për bazë së gjendja kur ka filluar gabimi në lexim ka ndodhur në muajin 10/2013 dhe gjendja e leximit e saktë është ajo e muajit 01/2014.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes korrigjimin e bërë nga DMK në ZRRE dhe ka vërejtur se DMK me rastin e llogaritjes së korrigjimit të konsumatorit ka bërë një gabim teknik gjatë evidentimit të gjendjes së tanishme të saktë që i përket muajit 01/2014, ku DMK ka evidentuar gjendjen TL=21002 kWh dhe TU=44125 kWh, por që në realitet gjendja e saktë e muajit 01/2014 ka qenë: TL=21202 kWh dhe TU=44125 kWh. Për më tepër Bordi i ZRRE-së e informon konsumatorin se po që se të dhënat e evidentuara si në vendimin e DMK-së do të ishin të sakta kalkulimi i bërë nga DMK do të ishte i saktë dhe veprim i duhur ligjor, mirëpo për shkak të gabimit teknik të ndodhur në ndërrimin e një shifre të gjendjes së njehsorit në tarifën e lartë ka rezultuar me një korrigjim jo të saktë.



Bordi i ZRRE-së konstaton se nëse merret saktë gjendja e muajit 01/2014 (TL=21202 kWh dhe TL=44125 kWh) dhe shpërndahet proporcionalisht duke u kthyer mbrapa deri në muajin 10/2013 rezulton se nuk ka elemente të korrigjimit që duhet t'i bëhet konsumatorit. Pra, korrigjimi i bërë nga DMK në ZRRE në vlerë prej -20.87€ duhet të shfuqizohet dhe të mos i llogaritet asnjë korrigjim konsumatorit pasi që gjatë shpërndarjes së shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 10/2013 e deri më 01/2014 nuk rezulton se duhet t'i bëhet korrigjimi financiar konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 11.11.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1230\_10\_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar